

# Hylli i Dritës

---

*Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.*

(II. ad Cor. III. 17).

---



VJETA XIII

—

Nanduer 1937

—

NUMRI 11.

---

Shtypshkroja Françeskane — Drejtimi: „Hylli i Dritës“ Shkoder

## D I F T O J S I

1. Kushlim	Fq. 501
2. Kuq e Zi	„ 502
3. Problemi i madh kundrue në 25 vjetorin shqyptár	„ 508
4. Flamuri komtár në krahinë të Shkoders	„ 515
5. Vorreve të Flamurit	„ 537
6. Lek Gruða	„ 546
7. Psehat per Vetëqeverimin Shqyptár	„ 547
8. Nji Kushtrim Shqyptarve	„ 553
9. Kolë Toma-Deð Gjo' Luli-Esað Toptani	„ 554
10. Kontributi i krahinës së Kurbinit per ças- stjen kombtare	„ 561
11. Historija e Bibliotekave në Shqipërië	„ 565
12. Kryengritja e Zadrimes	„ 566



# DISHMORVE VETERANVE FATOSAVE

QI

ME GJAK DJERSË E BURRNÍ

ME PUPEL BESË E TRIMNÍ

VLLAZNUEN ZËMRAT SHQYPTARE

KPUTEN PRANGAT E ROBNÍS QINDVJEÇARE

TUJ SHPEJTUE AGIMIN E HYLLIT TË LIRÍS

## **HYLLI I DRITËS**

BESNIK I QINDRUESHEM I IDEALIT TË TYNE

NË RASEN E GZUESHME TË 25-VJETORIT TË PAMVARSÍS

U FALET E U KUSHTOHET

ME EVARÍ E NDERIM

28-XI-1912

28-XI-1937

## Kuq e zí

### Epoepa e Flamurit Shqyptár

A thue dielli ndoj herë shdriti  
 Má me uzdajë per kombsi t' onë,  
 Se at herë kuer s' parit valviti  
 Kuq e zí Flamuri n' Vlonë,  
 Atje n' breg t' Adrijatikut,  
 N' ball t' anmikut, n' kohë t' rrezikut,  
 Shkjau n' Ballkan kuer s' drote Zot?

Burrë mbi burra Smajl Qemali,  
 S' pveti botën, pveti gjakun ;  
 Gryka e topavet s' e ndali  
 Mrenda Vlonës me ngulë bajrakun.  
 N' kushtrim t' tij, u trand Shqypnija  
 E briti njajze : „Rrnoftë Lirija !“  
 Qýsh n' Himarë e deri n' Hot.

Po, edhë t' deknit n' vorre u gzuene  
 Per ket ditë, qi i erdh Shqypnis ;  
 Bjeshkë e n' bjeshkë Malcít ushtuene  
 Prejë kushtrimit t' ditës s' liris ;  
 Pse ajo Vlona e Smajl Qemalit  
 Gzoi shka kje, edhë gurt e malit,  
 Lumnoj mik -- mjeroj anmik.

Kshtú nji ditë ! E sot Shqypnija  
 T' falet, Flamur, mbí truell t' parve !  
 S' njofti Athinë as Rromë njerzija,  
 Kuer valvitshe n' gjak t' Shqyptarve.  
 N' tý nderojmë na gjakun t' onë,  
 Me burra, qi t' ngríjtne n' Vlonë,  
 Kombi marë kuer kje n' rrezik.

